



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 3 dhjetor 2018
Nr. ref.:RK 1294/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO79/18

Parashtrues

Presidenti i Republikës së Kosovës

**Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, Hashim Thaçi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
3. Parashtruesi i kërkesës i parashtoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pyetjen si në vijim:

“Nga cilat grupet parlamentare duhet të emërohen anëtarët e KQZ-së:

1.1. nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës?; apo

1.2. nga grupet parlamentare që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës?”

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 84 (9) në lidhje me nenin 113 të Kushtetutës.
5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës), e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 7 qershor 2018, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu – Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
9. Më 24 gusht 2018, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës parashtruesin e kërkesës, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryetari i Kuvendit) dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kryeministri).
10. Kryetarit të Kuvendit iu kërkuar që një kopje e kërkesës t'i dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe i ftoi deputetët që të dorëzojnë komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, deri më 20 shtator 2018.

11. Më 11 shtator 2018, Gjykata i kërkoi Zyrës së Presidentit dorëzimin e kopjeve të dekreteve të Presidentit të Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të përbërjes së fundit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
12. Më 13 shtator 2018, Zyra e Presidentit dorëzoi në Gjykatë kopjet e dekreteve të kërkuara.
13. Më 19 shtator dhe 20 shtator 2018, Ismet Beqiri, deputet i Kuvendit, Albulena Haxhiu, në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të grupit parlamentar të Partisë Socialdemokrate dhe Bilall Sherifi, në emër të grupit parlamentar Nisma Socialdemokrate dorëzuan komentet e tyre përkitazi me kërkesën.
14. Më 24 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës përkitazi me komentet dhe e ftoi që të dorëzojë komentet e tij, nëse ka, deri më 28 shtator 2018. Parashtruesi i kërkesës nuk dorëzoi përgjigje përkitazi me komentet e lartcekura të deputetit dhe grupeve parlamentare.
15. Të njëjtën ditë, Gjykata po ashtu njoftoi Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin përkitazi me komentet. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që kopjet e të gjitha komenteve t'u dorëzohen të gjithë deputetëve të Kuvendit.
16. Më 25 shtator 2018, Gjykata i parashtroi pyetje Forumit të Komisionit të Venecias.
17. Më 26 shtator deri më 29 tetor 2018, Gjykata pranoi përgjigjet nga Gjykatat Kushtetuese/Supreme të Austrisë, Holandës, Sllovakisë, Kroacisë, Luksemburgut, Irlandës, Lituanisë, Bullgarisë, Afrikës së Jugut, Norvegjisë, Çekisë, Gjermanisë dhe Letonisë.
18. Më 21 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe, me shumicë, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.
19. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, me shumicë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

20. Më 16 dhjetor 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës në bazë të nominimit nga grupet parlamentare dhe partitë politike të komuniteteve jo - shumicë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi) emëroi anëtarët e Komisionit Qendror për Zgjedhje (në tekstin e mëtejshëm: KQZ).
21. Më 11 qershor 2017, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend.
22. Më 21 qershor 2017, Presidenti shpalli zgjedhjet për kuvende komunale dhe kryetarë të komunave në Republikën e Kosovës.

23. Më 8 korrik 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: KQZ) certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend.
24. Me 3 gusht 2017, Kuvendi mbajti seancën konstituive dhe mes tjerash formoi Komisionin *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe mandateve (në tekstin e mëtejme: Komisioni *ad hoc*).
25. Të njëjtën ditë, Komisioni *ad hoc* paraqiti raportin, bazuar në listën e rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve dhe konstatoi mandatet si në vijim:
 - a) Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës, Alternativa Demokratike e Kosovës, Republikanët e Kosovës, Partia e Ballit, Partia Socialdemokrate, Balli Kombëtar i Kosovës (në tekstin e mëtejme: PDK, AAK dhe Nisma), 39 deputetë;
 - b) Lëvizja "Vetëvendosje!" (në tekstin e mëtejme: LVV), 32 deputetë;
 - c) Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re (në tekstin e mëtejme: LDK dhe AKR), 29 deputetë;
 - d) Gradanska Iniciativa Srpska lista, 9 deputetë;
 - e) Kosova Demokratik Tyrk Partisi, 2 deputetë;
 - f) Koalicija "Vakat", 2 deputetë;
 - g) Nova Demokratska Stranka, 1 deputet;
 - h) Samostalna Liberalna Stranka, 1 deputet;
 - i) Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, 1 deputet;
 - j) Partia Liberale Egjyptiane, 1 deputet;
 - k) Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;
 - l) Partia e Ashkalinjëve për Integritet, 1 deputet; dhe
 - m) Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.
26. Më 7 shtator 2017, me zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkyetarëve u konstituua Kuvendi.
27. Në shtator të vitit 2017, një numër deputetësh, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar, Nisma Socialdemokrate.
28. Në shtator të vitit 2017, një numër deputetësh, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (në tekstin e mëtejme: AAK).
29. Më 22 tetor 2017, u mbajtën zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.
30. Më 27 dhjetor 2017, KQZ certifikoi rezultatin e zgjedhjeve lokale.
31. Më 14 mars 2018, dymbëdhjetë (12) deputetë, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar, Grupi i Deputetëve të Pavarur.
32. Më 27 prill 2018, Presidenti i Republikës, emëroi znj. Valdete Daka, Kryesuese të KQZ-së.

Kërkesa e parashtruesit

33. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] paragrafi 4, të Kushtetutës.

34. Në dritën e kërkesës së tij, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të përgjigjet në pyetjet vijuese:

“Nga cilat grupet parlamentare duhet të emërohen anëtarët e KQZ-së:

1.3. nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës?; apo

1.4. nga grupet parlamentare që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës?”

35. Në lidhje me pyetjen e lartcekur, parashtruesi e sqaron kërkesën e tij si në vijim:

“Në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (GZ, Nr. 31, 15 qershor 2008), Presidenti është në fazën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së me mandat të ri.

Për të shmangur çdo dilemë në emërimin e anëtarëve të KQZ-së, kërkoj nga Gjykata Kushtetuese që në frymën e Kushtetutës, të interpretojë nenin 139, paragrafi 4, të Kushtetutës [...].”

36. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, parashtruesi argumenton:

“Kërkesa parashtrohet në pajtim me nenin 84 (9) të Kushtetutës, ngase kjo dispozitë i jep Presidentit kompetencë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, kur ka të paqartë çështje kushtetuese, të cilat i has gjatë ushtrimit të kompetencave të garantuara me Kushtetutë dhe me qëllim të realizimit të rolit primar të Presidentit, si përfaqësues i unitetit juridik kushtetues të popullit të Kosovës dhe si garantues i funksionimit demokratik të institucioneve dhe të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës.”

37. Sipas parashtruesit të kërkesës: “Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e Kushtetutës, është përcaktuar me nenin 112.1 të Kushtetutës:

“Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Neni 84 (9), i Kushtetutës shprehimisht i jep Presidentit kompetencë për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë sipas kësaj dispozite kushtetuese është një kompetencë e gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës.

Presidenti bart përgjegjësinë e zbatimit të Kushtetutës dhe garantimin e funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës. Në zbatimin e një përgjegjësie të tillë kushtetuese, Presidenti mund të dërgojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në raste kur nevojitet qartësim në lidhje me një situatë kur dispozita kushtetuese është e paqartë, dhe kërkohet të merret Vendim që prodhon efekte juridike.

Në këtë kontekst, paraqiten paqartësi se cilat janë grupet parlamentare që kanë të drejtën e nominimit/propozimit të anëtarit/ve për t'u emëruar anëtar/e të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (Në tekstin në vijim: KQZ), nga ana e Presidentit. Në këtë drejtim, Presidenti shfrytëzon kompetencën e tij kushtetuese për referim të kësaj çështje kushtetuese, për të sqaruar se nga cilat grupe parlamentare duhet të emërohen anëtarët e KQZ-së.”

38. Parashtruesi i kërkesës, më tej, arsyeton se: “Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 112 të Kushtetutës, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës ka jurisdiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Pa dyshim, në këtë rast, këto dy kushte plotësohen dhe rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë interpretimin e dispozitave kushtetuese kurdo që një çështje i adresohet asaj nga institucione të mandatuara për referim. Në rastin konkret, kërkohet interpretimi i nenit 139, paragrafi 4 i Kushtetutës, në atë mënyrë që të qartësohet kjo dispozitë kushtetuese dhe t'i mundësohet Presidentit të konsolidojë KQZ-në, duke i emëruar anëtarët e saj.”
39. Parashtruesi i kërkesës në fund thekson se: “[n]ë rrjedhë të asaj që u theksua më lartë, pranueshmëria e kësaj kërkeje nga Gjykata Kushtetuese është e vetëkuptueshme.”

Pyetjet e parashtruara Forumit të Komisionit të Venecias dhe përmbledhja e përgjigjeve

Pyetjet

1. A ekziston ndonjë përkufizim kushtetues për grupin parlamentar (grupet parlamentare)?
2. A ka ndonjë afat kushtetues (ligjor) prej kur themelohet zyrtarisht një grup parlamentar? Në cilën fazë autorizohen (kanë të drejtë) grupet parlamentare të propozojnë ose të nominojnë kandidatë për emërim në organe të ndryshme (p.sh., në komisione parlamentare, në komisione parlamentare ad hoc, në institucione të pavarura)?
3. Nëse është e zbatueshme në vendin tuaj, cila është praktika relevante për emërimin e anëtarëve të KQZ-së, më konkretisht, a zgjidhen anëtarët e KQZ-së:

(a) nga radhët e grupeve parlamentare që dalin nga subjektet politike që kanë dalë drejtpërsëdrejti nga zgjedhjet, dhe si të tilla kanë fituar ulëse në Kuvend/Parlament; ose

(b) nga radhët e grupeve parlamentare që janë krijuar pas konstituimit të Kuvendit/Parlamentit (dhe të cilat mund të korrespondojnë, ose jo, me grupet parlamentare që kanë dalë automatikisht nga subjektet (koalicionet) politike që kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor?

A ka ndonjë praktikë gjyqësore relevante në lidhje me objektin e çështjes që mbulohet nga pyetjet paraprake ose ndonjë situatë tjetër që mund të jetë relevante për qëllimet e këtij objekti të çështjes?

Përgjigjet e Gjykatave Kushtetuese/Supreme, të dorëzuara përmes Forumit të Komisionit të Venecias

40. Bazuar në përgjigjet e Gjykatave Kushtetuese/Supreme, të dorëzuara përmes Forumit të Komisionit të Venecias, vërehet se dispozitat e kushtetutave të këtyre shteteve nuk parashohin një përkufizim për grupet parlamentare.
41. Po ashtu, bazuar në përgjigjet e Gjykatave Kushtetuese/Supreme, të dorëzuara përmes Forumit të Komisionit të Venecias, rezulton që në shumicën e këtyre shteteve, Komisionet Qendrore Zgjedhore janë Komisione të përhershme dhe profesionale që përbëhen nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, atyre qeveritare dhe të gjyqësorit. Ndërkaq, në disa raste janë të përbëra nga anëtarë që propozohen qoftë drejtpërsëdrejti nga partitë politike, apo nga grupet parlamentare të përfaqësuara në Parlament.

Komentet e paraqitura nga deputeti Ismet Beqiri dhe nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare

Komentet e deputetit Ismet Beqiri

42. Deputeti Ismet Beqiri në komentet e paraqitura më 19 shtator 2018, ndër të tjera, argumentoi se "[...] kjo dispozitë, është e qartë edhe për faktin se implementimi i saj në praktikë nuk është duke ndodhur për herë të parë në shtetin tonë. Të gjitha përbërjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute dhe themelimi i KQZ-së, janë ndërtuar duke e marrë për baze numrin e grupeve parlamentare ashtu siç kanë dalë nga procesi zgjedhor, duke u bazuar në rezultatet e tyre dhe në procesin e verifikimit të grupeve dhe të mandateve të secilit deputet veç e veç në seancat konstituive të të gjitha legjislatrave të mëhershme. Si e tillë, kjo formulë e ndarjes së vendeve ka qene gjithmonë e pranueshme nga të gjithë akterët dhe si rrjedhojë nuk kemi pasur asnjëherë ndonjë kontestim dhe as me të voglën dilemë në frymën e pyetjes së shtruar për institucionin Tuaj nga ana e Presidentit të Kosovës."
43. Z. Beqiri, më tej, arsyeton se "[...] në dispozitën për të cilën është kërkuar interpretim behët fjale vetëm për grupet parlamentare të cilat si të tilla dalin nga procesi zgjedhor, dhe jo për grupet të cilat mund të krijohen, shuhen, krijohen e shuhen... në pa kufi raste gjatë një legjislature [...]."
44. Sipas z. Beqiri "[...] në pajtim me nenin 61, paragrafi 4 të Ligjit 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme limiti i epërm kohor është gjashtëdhjetë (60) ditë dhe

se procesi i emërimit të anëtareve të KQZ së mund të zhvillohet menjëherë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, madje edhe para konstituimit të Kuvendit (sepse sipas nenit 66.1 të Kushtetutës, seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës duhet të mbahet brenda 30 ditësh nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve)."

45. Z. Beqiri përfundon: "Prandaj interpretimi ndryshe, nga ai që e gjejmë të qartë në përmbajtjen e nenit 139.4 të Kushtetutës dhe të praktikuar në vazhdimësi deri më sot, se vendet në KQZ ndahen nga grupet të cilat si të tilla kanë dalë nga zgjedhjet, nuk ka asnjë logjikë juridike e as institucionale dhe do ta dëmtonte jashtëzakonisht shumë KQZ-në dhe punën e këtij institucioni kaq të ndjeshëm."

Komentet e Grupit parlamentar Lëvizja Vetëvendosje

46. Në komentet e paraqitura nga znj. Albulena Haxhiu në emër të Grupit parlamentar të Vetëvendosjes më 20 shtator 2018, ndër të tjera u theksua: "Paragrafi 4, i nenit 61 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme e përcakton se "Mandati i anëtareve të KQZ-se fillon jo me vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend ". Ky paragraf, përtej afatit se kur duhet të fillojë më së voni mandati i anëtareve të KQZ-së, e qartëson gjithashtu edhe kriterin ligjor mbi subjektet legjitime për të bërë nominime për anëtarë të KQZ-se, sikurse që e garanton mekanizmin e domosdoshëm për vazhdimësi institucionale të një institucioni të përhershëm kushtetues. Po e theksojmë, ky afat lidhet me ditën e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve dhe jo me ditën apo datën e konstituimit të Kuvendit. Nga kjo shihet se funksionalizimi i KQZ-së nuk ka kurrfarë ndërlidhje me konstituimin e Kuvendit. Madje konstituimi i Kuvendit mund të shkojë përtej kësaj periudhe prej 60 ditësh nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, sikurse që dështimi i Kuvendit pas konstituimit për të zgjedhur Kryeministrin do ta qonte vendin në zgjedhje të parakohshme, për të cilat KQZ do të duhej të ishte tashmë funksionale."

47. Në vijim, Znj. Haxhiu arsyeton se "Nisur nga fryma e Kushtetutës së Republikës, në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.KO119/14, mbështetur në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në bazë të vendimit të KQZ-së për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të përgjithshme të 11 qershorit 2017, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të përbehet nga anëtarët që përfaqësojnë grupet parlamentare që kanë dalë si subjekte politike nga rezultati i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe që kanë kaluar pragun parlamentar.[...]."

Komentet e Grupit parlamentar Partia Socialdemokrate

48. Në komentet e paraqitura nga z. Visar Imeri, në emër të Grupit parlamentar të PSD më 20 shtator 2018 u theksua si në vijim:

"Teksti kushtetues në këtë dispozitë ka përdorur termin "të përfaqësuara". Termi i tillë që është përdorur në këtë dispozitë ka karakter post festum. Kjo nënkupton se jo domosdoshmërisht subjekti politik që ka fituar mandate të caktuara në Kuvend do të jetë përfaqësuar në nivel të grupit parlamentar

me poaq deputetë të mandatuar. Dhe meqenëse baza e fitimit të së drejtës për të nominuar përfaqësuesin për emërim në cilësi të anëtarit të KQZ-së ndërlidhet ngushtë me autorizimet kushtetuese lidhur me morfologjinë e mandatit kushtetues të deputeteve, si anëtarë të organit me të lartë kushtetues me karakter ligjvënës. Është dispozita e nenit 70, paragrafit 1 e cila i jep lirinë e ushtrimit të funksionit të deputetit brenda mandatit të tij duke mos iu nënshtruar asnjë mandati tjetër të detyrueshëm. Përforcimi i lirisë së përcaktimit politik brenda strukturës politike të deputeteve si anëtarë të Kuvendit, ndërlidhet me vetë natyrën e përfaqësimit. Përfaqësimi është nocion dinamik. Pra është i lëvizshëm. Dinamizmi i tij shprehet edhe me përkufizimin e mandatit në kuptim kohor. Këto janë madje ndër prerogativat themelore të demokracisë përfaqësuese, meqë përmes kufizimit kohor të mandateve stimulohet dinamizmi i përfaqësimit."

49. Në fund z. Imeri vlerësoi: "Të gjitha këto pyetje eliminohen me interpretimin e tillë që "Presidenti do të emëroje anëtarët e KQZ-së nga radhët e grupeve parlamentare -ato që janë krijuar dhe funksionojnë në kuadrin e strukturës së brendshme politike të Kuvendit. [...] Andaj, sipas të thënave si më lartë, konsiderojmë se në pyetjet alternative që janë përfshirë në Kërkesën KO79/18 nga Presidenti i Kosovës, përgjigja për interpretim të dispozitës së nenit 139 paragrafit 4 të Kushtetutës së Kosovës duhet gjetur në modalitetin e pyetjes së dytë, respektivisht se: "Anëtarët e KQZ-së duhet zgjedhur nga radhët e grupeve parlamentare me të drejtë të nominimit të përfaqësuesve në KQZ, që janë krijuar pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës, respektivisht sipas gjendjes në të cilën reflekton përbërja e grupeve parlamentare kur duhet bërë nominimi i përfaqësuesve për emërim në KQZ."

Komentet e Grupit parlamentar Nisma Socialdemokrate

50. Më 20 shtator 2018, z. Bilall Sherifi, në emër të Grupit parlamentar Nisma Socialdemokrate në thelb theksoi si në vijim:

"Pyetja e Presidentit të Republikës së Kosovës për Gjykatën Kushtetuese nuk ka relevancë juridike kushtetuese për emërimin e anëtarëve të KQZ-së për sa i takon kohës së themelimit të Grupeve Parlamentare pasi që ekziston sipas interpretimit të gjykatës KO119/14 vetëm një kohë dhe ajo është pas Konstituimit të Kuvendit.

1. Nuk ekzistojnë grupet parlamentare të dala nga zgjedhjet dhe pas konstituimit të Kuvendit siç Presidenti e ka parashtruar pyetjen, por ekzistojnë grupet parlamentare vetëm pas Konstituimit të Kuvendit.

2. Nuk ekziston asnjë dilemë juridike që Grupet Parlamentare të themeluara pas Konstituimit të Kuvendit duhet të përfaqësohen me anëtar sipas fuqisë së votës në KQZ shih nenin 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 61 të Ligjit Nr.03/L-073/2008.

Grupi Parlamentar i Nismasocialdemokrate bazuar nga argumentet e parashtruara në këto komente është e bindur se Gjykata Kushtetuese do të ruaj kontinuitetin e interpretimit të saj në aktgjykimin KO119/14, përkritazi me relevancë kohore të themelimit të grupeve parlamentare siç është përshkruar me lartë ashtu që Grupi Parlamentar i Nisma që tash ka 8 deputet të ketë të drejtën e përfaqësimit me anëtar në Komisionin Qendror

Zgjedhor konform nenit 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 61 të Ligjit Për Zgjedhjet Qendrore në Republikën e Kosovës.”

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 84

[Kompetencat e Presidentit]

[...]

(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

[...]

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

[...]

Neni 139

[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

[...]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdiksion apeli.

4. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (publikuar në Gazetën Zyrtarë më 15 qershor 2008)

Neni 61
Mandati dhe Emërimi i Anëtarëve të KQZ-së

61.1 Kryesuesi i KQZ-së emërohet në pajtueshmëri me nenin 139.3 të Kushtetutës së Kosovës.

61.2 Mandati i Kryetarit të KQZ-së është shtatë (7) vjet duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës.

61.3 Neni 139.4 i Kushtetutës së Kosovës parasheh se caktimi i anëtarëve të KQZ-së duhet të bëhet sipas procedurave në vijim:

a) Brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit(ve) në KQZ e njoftojnë Presidentin e Kosovës për nominimin e tyre. Pas sigurimit se individi i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të këtij ligji, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në Emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës;

b) Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben në më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme;

c) Anëtarët e KQZ-së nuk shërbejnë në më shumë se tri (3) mandate të njëpasnjëshme;

d) Përfundimi i mandatit bëhet në ditën e fundit të muajit kalendarik, në të njëjtin muaj në të cilin ka filluar mandati;

e) Pavarësisht nga pika (d) e këtij paragrafi mandati që përfundon nëntëdhjetë (90) ditë ose më pak para zgjedhjeve ose deri 90 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, automatikisht zgjatet për 90 ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore.

61.4 Mandati i anëtarëve të KQZ-së fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend.

Pranueshmëria e kërkesës

51. Gjykata fillimisht vlerëson nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në Rregulloren e Punës.
52. Neni 113, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton që "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".
53. Gjykata thekson që Presidenti i Republikës së Kosovës është palë e autorizuar sipas nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës.

54. Në bazë të nenit 113, paragrafi 2, të Kushtetutës, "[...] Presidenti i Republikës së Kosovës [...] [është i] autorizuar të ngrejë rastet në vijim:
- (1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të [...] Kryeministrit, dhe të rregulloreve të qeverisë, me Kushtetutën;
 - (2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.
55. Më tej, neni 113, paragrafi 3, i Kushtetutës, përcakton që [...], Presidenti i Republikës së Kosovës [...] [është i] autorizuar të ngrejë çështjet në vijim:
- (1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
 - (2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;
 - (3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
 - (4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
 - (5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.
56. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, shprehimisht parasheh rastet që Presidenti i Republikës mund t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese.
57. Rrjedhimisht, Gjykata thekson që e drejta e palëve të autorizuara sipas Kushtetutës, për të parashtruar kërkesa në Gjykatë, buron nga neni 113 i Kushtetutës. Përfundimisht nga kjo përbën situata që ndërlidhet me nenin 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal], paragrafi 4, të Kushtetutës, si dhe rastet që mund të burojnë nga juridiksioni shtesë që mund të rregullohet me ligj, siç parashihet në nenin 113, paragrafi 10, të Kushtetutës.
58. Neni 62, paragrafi 4 i Kushtetutës përcakton:
- "Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuar me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrtojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do ta paranojë ta shqyrtojë rastin përkatës."*
59. Megjithatë, edhe në lidhje me këtë përjashtim, kur rasti mbi këtë bazë parashtrohet drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese, është në diskrecionin e Gjykatës që të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës (Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO01/09, *Parashtrues: Qemajl Kurtishi*, zëvendës Kryetar i Komunës së Prizrenit, të 18 marsit 2010).
60. Gjykata rikujton se parashtruesi kërkon interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror për Zgjedhje], paragrafit 4, të Kushtetutës, dhe kërkesën e tij për interpretim e ka mbështetur në nenin 84 (9), si dhe në nenin 112, paragrafi 1, të Kushtetutës.

61. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren që çështja që ngrit parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk hyn në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese siç parashihet me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 113 të Kushtetutës. Për më tepër, një gjë e tillë as nuk është kërkuar apo saktësuar nga parashtruesi në kërkesën e tij.
62. Në vijim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson: *“Neni 84 (9), i Kushtetutës shprehimisht i jep Presidentit kompetencë për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë sipas kësaj dispozite kushtetuese është një kompetencë e gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës.”*
63. Parashtruesi i kërkesës deklaron tutje se, sipas nenit 84 (9) të Kushtetutës, Presidenti ka kompetencë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese *“[...] ngase kjo dispozitë i jep Presidentit kompetencë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, kur ka të paqartë çështje kushtetuese, të cilat i has gjatë ushtrimit të kompetencave të garantuara me Kushtetutë dhe me qëllim të realizmit të rolit primar të Presidentit, si përfaqësues i unitetit juridik kushtetues të popullit të Kosovës dhe si garantues i funksionimit demokratik të institucioneve dhe të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës... Presidenti mund të dërgojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në raste kur nevojitet qartësim në lidhje me një situatë kur dispozita kushtetuese është e paqartë, dhe kërkohet të merret Vendim që prodhon efekte juridike.”*
64. Po ashtu, parashtruesi deklaron se *“Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 112 të Kushtetutës, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës ka juridiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar...”* duke shtuar se *“[...] pranueshmëria e kësaj kërkeje nga Gjykata Kushtetuese është e vetëkuptueshme.”*
65. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se neni 112 i Kushtetutës përcakton që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
66. Andaj, ashtu siç me të drejtë specifikohet në përmbajtjen e kërkesës së parashtruesit, Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 113, paragrafit 1 të Kushtetutës ka juridiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
67. Në këtë kuptim, Gjykata është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, sipas nenit 112, paragrafit 1 të Kushtetutës, në lidhje me rastet e ngritura para saj sikurse përcaktohet me nenin 113. Gjykata nuk merret me interpretime për çështje që lidhen me veprime ose mosveprime juridike të institucioneve kushtetuese për të cilat nuk është e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës. Prandaj, neni 112, paragrafi 1, i Kushtetutës nuk mund të interpretohet jashtë kontekstit të nenit 113 të Kushtetutës.

68. Në lidhje me kuptimin dhe me kufijtë e nenit 84 (9) të Kushtetutës, Gjykata thekson se kërkesat e parashtruara mbi këtë bazë mund të jenë të pranueshme vetëm brenda juridiksionit të rregullt të Gjykatës, të përcaktuar shprehimisht dhe qartë në nenin 113, paragrafët 2 dhe 3.
69. Gjykata, në praktikën e saj të mëparshme gjyqësore, duke aplikuar kuptimin e zgjeruar të nocionit “çështje kushtetuese”, kishte shqyrtuar kërkesa që nuk përfshihen shprehimisht në kufijtë e juridiksionit të saj të përcaktuar me nenin 113, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës. Gjykatës i ishte kërkuar nga Presidenti/ja e Republikës që të interpretojë kuptimin e dispozitave specifike të Kushtetutës (shih, p. sh., rastin nr. KO80/10, *Presidenti i Republikës së Kosovës*; Aktgjykim i 7 tetorit 2010; rasti nr. KO97/10, *Ushtruesi i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2010; rasti nr. KO57/12, *Presidentja e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 22 tetorit 2012; rasti nr. KO103/14, *Presidentja e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2014).
70. Gjithashtu, në praktikën e saj, Gjykata kishte theksuar se është në diskrecionin e saj të vendosë nëse çështja e ngritur është një “çështje kushtetuese” dhe për këtë të vendosë nga rasti në rast. Gjykata, në fakt, kishte vlerësuar se “jo çdo çështje që [parashtruesi i kërkesës] pretendon të ngrejë çështje kushtetuese mund të jetë për se çështje e tillë” (Shih Aktgjykimin në rastin KO130/15, *Presidentja e Republikës së Kosovës*, në lidhje me përrputhshmërinë e parimeve që përmban dokumenti i titulluar “Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore” me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cekur më lart, Aktgjykim i 23 dhjetorit 2015, paragrafi 101).
71. Praktika e mëhershme e Gjykatës në lidhje me trajtimin e kërkesave të parashtruara në kuptimin e gjerë të nocionit “çështje kushtetuese”, duhet kuptuar në frymën e procesit të vendosjes së themeleve të gjyqësisë kushtetuese, si dhe të nevojës shoqërore që Gjykata në fillesat e saj të përfshihet në interpretime të neneve specifike të Kushtetutës, sidomos kur çështjet e parashtruara janë ndërlidhur me ushtrimin e kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë; kur çështjet e ngritura kanë ndikuar në ndarjen e pushteteve; në ruajtjen e rendit kushtetues; si dhe kur çështjet e ngritura kishin implikime thelbësore në funksionimin e sistemit kushtetues të vendit (Shih Aktgjykimin në rastin KO130/15, *Presidentja e Republikës së Kosovës*, të cekur më lart, paragrafët 104, 107 dhe 109. Shih, po ashtu, rastin nr. KO103/14, *Presidentja e Republikës së Kosovës*, të cekur më lart, Aktgjykim i 1 korrikut 2014, paragrafët 27, 57 dhe 61).
72. Megjithatë, Gjykata në përbërjen e saj aktuale, vlerëson se në përrputhje të plotë me gjuhën e qartë, shteruese dhe kufizuese të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të gjitha referencat tjera në Kushtetutë që ndërlidhen me ngritjen e çështjeve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, burojnë nga neni 113.
73. Mbi këtë bazë, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruar nuk bie në kufij të nenit 113, për shkak se në bazë të nenit 113, paragrafi 2, Presidenti mund të ngrejë

çështje që ndërlidhen me përputhshmërinë me Kushtetutën të ligjeve, të akteve të Qeverisë dhe të Kryeministrit, të përcaktuara në 113.2 (1), si dhe të Statutit të Komunës, të përcaktuar në 113.2 (2) të Kushtetutës.

74. Ndërsa, në bazë të nenit 113, paragrafi 3, Presidenti është i autorizuar të ngrejë çështje që ndërlidhen me situata të konfliktit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentit dhe të Qeverisë; përputhshmërinë e referendumit me Kushtetutën; përputhshmërinë e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë kësaj gjendjeje, me Kushtetutën; përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese me marrëveshjet ndërkombëtare dhe rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur; si dhe kushtetutshmërinë e procesit të zgjedhjes së Kuvendit.
75. Rrjedhimisht, edhe kompetenca e parashtruesit të kërkesës, sipas nenit 84 (9) të Kushtetutës, duhet të ndërlidhet me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, e cila përcakton shprehimisht dhe në mënyrë shteruese çështjet që Presidenti i Republikës mund t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese.
76. Duke u nisur nga fakti që Kushtetuta ka përcaktuar shprehimisht juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe palët e autorizuar për aktivizimin e juridiksionit të saj, Gjykatës i është kufizuar mundësia që të marrë rol konsultativ apo këshillëdhënës, ngase ky rol do të binte ndesh me rolin e saj themelor për vendosjen e rasteve të ngritura para saj. Praktika e vendeve të tjera njeh raste kur gjykatat kushtetuese kanë ushtruar juridiksion këshillëdhënës, por më vonë një praktikë e tillë e juridiksionit të natyrës konsultative është hequr për shkak të inkompatibilitetit të saj me natyrën vendimmarrëse të gjykatave kushtetuese. Konkretisht, në rastin e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, Ligji për Gjykatën Federale Kushtetuese, në fillet e ekzistimit të saj kishte paraparë mundësinë e dhënies së mendimeve këshillëdhënëse nga kjo gjykatë (Ligji për Gjykatën Federale Kushtetuese të Gjermanisë, *BVerfGG*, i 12 marsit 1951). Megjithatë, vetëm disa vite më vonë, për shkak të natyrës detyruese të “mendimeve këshilluese”, dispozita e ligjit të lartcekur, që lejonte një juridiksion të tillë, ishte shfuqizuar (më 21 korrik 1956).
77. Gjykata rithekson se përmbajtja e dispozitës së nenit 113 të Kushtetutës, marrë në tërësinë e saj, është e qartë dhe konkrete për sa u përket kompetencave të Presidentit që dalin nga konteksti i palës së autorizuar para Gjykatës Kushtetuese.
78. Rrjedhimisht, rezulton që neni 113 paraqet bazën themelore dhe të vetme juridiksionale të Gjykatës në lidhje me autorizimet e Presidentit si palë e autorizuar para Gjykatës Kushtetuese.
79. Gjykata, për më tepër, rikujton se parashtruesi në kërkesën tij kërkon interpretimin e nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës, i cili përcakton që:

“Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë

anëtarë shtesë. Një (1) anëtar emërohet nga deputetë të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë”.

80. Prandaj, kërkesa e parashtruar nuk ka të bëjë me çështje që shprehimisht ndërlidhen me ushtrimin e përgjegjësiwe kushtetuese të Presidentit, për arsye se as në nenin 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe as në nenin 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], të Kushtetutës, nuk është përcaktuar kompetenca e Presidentit për emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, respektivisht:

Neni 84

[Kompetencat e Presidentit]

[...]

(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

[...]

Neni 139

[...]

[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

[...]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli.

[...]

81. Për dallim nga nenet 84 (26) dhe 139 (3) të Kushtetutës, që përcaktojnë shprehimisht kompetencën e Presidentit për emërimin e Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kompetenca e Presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së është përcaktuar shprehimisht vetëm me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenin 61, paragrafi 3 (a).
82. Në fund, Gjykata konstaton se në mënyrë që Gjykata të vlerësoj kërkesën e parashtruesit, kërkesa duhet të mbështetet në nenin 113 të Kushtetutës.
83. Prandaj, bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata gjen se çështjet e ngritura nga parashtruesi para Gjykatës nuk hyjnë në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, Gjykata përfundon se kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, ne pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, me rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, më 21 nëntor 2018, me shumicë

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarija e Gjykatën Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi